



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

Univerziteti i Kosovës - Hospital and University Clinical Service of Kosovo

RREGULLORE

për

procedurat e përgjegjësisë

disiplinore dhe materiale

Aprovuar më _____

Prishtinë

Në mbështetje me nenin 45 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, nenin 84, 85 dhe 86 të Ligjit 03/L-212 të Punës dhe Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Bordi Drejtues i SHSKUK-se më datën ----- miraton këtë:

RREGULLORE

për procedurat e përgjegjësitë disiplinore dhe materiale

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen;

klasifikimi i shkeljeve disiplinore dhe sjelljeve në kundërshtim me etikën, procedurat disiplinore dhe masat tjera disiplinore dhe materiale që u shqiptohen shërbyesve spitalor të institucioneve shëndetësore të nivelit tretësor dhe atij dytësor.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në të gjitha institucionet shëndetësore të Republikës së Kosovës, ku janë në marrëdhënie pune punëtorët shëndetësorë dhe punëtorët që kryejnë veprimtari tjera në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK-së).

Neni 3 Përkufizimet

Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë rregullore, kanë kuptimin e paraparë me Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125, Ligjin e Punës 03/L-212 dhe Kodin e Etikës Mjekësore.

Neni 4 Paraqitja e shkeljes disiplinore apo dëmit

Shkeljet disiplinore paraqiten nga:

1. Udhëheqësit me të lartë dhe udhëheqësit e drejtpërdrejt
2. Shërbyesit spitalor dhe klinik
3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve.

Neni 5

Shkeljet e detyrave të punës

1. Shkeljet e detyrave të punës ndahen;
 - 1.1 Shkelje të lehta dhe
 - 1.2 Shkelje të rënda/serioze

Shkeljet e lehta konsiderohen:

- 1.1. Shkeljet e lehta të Kodit të Etikës Mjekësore nga punonjësit spitalor dhe klinik;
- 1.2. Mos mbajtja e kartelës identifikuese;
- 1.3. Dy mungesa të paarsyeshme me kohëzgjatje një ditore brenda vitit kalendarik;
- 1.4. Mos respektimi i orarit të punës;
- 1.5. Mos informimi për mungesën në punë;
- 1.6. Mos respektimi i normave për veshjen dhe paraqitjen;
- 1.7. Mos bindje ndaj udhëheqësve të drejtpërdrejt dhe të lartë;
- 1.8. Komunikimi me zhurmë (ton të lartë) brenda hapësirave të institucionit;
2. Gabimet e vogla të rastit nuk do të jenë temë disiplinore, por, do të zgjidhen në kuadër të menaxhimit të përditshëm.
3. Shkeljet e lehta, nëse përsëriten mbi dy herë, konsiderohen shkelje të rënda.

Neni 7

Shkeljet e rënda –serioze

1. Shkelje të rënda/serioze konsiderohen:
 - 1.1 Shkelje të rënda/serioze të Kodit të Etikës Mjekësore, për punonjësit spitalor dhe klinik
 - 1.2 Vjedhja;
 - 1.3 Mashtrimi;
 - 1.4 Falsifikimi i dokumenteve personale dhe të pacientit;
 - 1.5 Ushtrimi i dhunës fizike ndaj personelit/kolegëve të punës apo presione të ndryshme psikike;
 - 1.6 Keqtrajtim ose diskriminim i rëndë në punë;
 - 1.7 Ardhja në punë nën ndikim të alkoolit apo drogave ose përdorimi i tyre gjatë orarit të punës;
 - 1.8 Dëmtimi i pronës së institucionit;
 - 1.9 Shkelja e detyrave të punës që kanë pasoja për pacientët dhe institucionin;
 - 1.10 Diskreditimi dhe komprometimi serioz ndaj pacientëve dhe kolegëve;
 - 1.11 Shkelje serioze të rregullave, që ndërliken me shëndetin dhe sigurinë e punonjësve dhe pacientit;
 - 1.12 Mos informimi dhe mungesa e paarsyeshme për dy (2) dite pune të një pas njëshme brenda një viti kalendarik;
 - 1.13 Dhënia e deklaratës së rrejshme në lidhje me konfliktin e interesit;
 - 1.14 Keqpërdorimi me pajisje mjekësore, barna dhe të gjitha produktet tjera mjekësore që janë në nevojë të pacientëve;
 - 1.15. Kryerja e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e institucionit apo veprimet që e dëmtojnë institucionin dhe organet tjera;
 - 1.16 Sjellja apo kërcënim i pengon apo ua vështirëson të tjerëve kryerjen me sukses të detyrave profesionale të punës;
 - 1.17 Mos ofrimi i ndihmës profesionale në kuadër të kompetencave dhe detyrave të punës që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën profesionale;
 - 1.18 Marrja e biopsisë për kërkime shkencore individuale pa pëlqimin e pacientit si dhe pëlqimin nga institucioni përkatës;
 - 1.19 Veprimi apo mos veprimi i cili shpie deri te zbulimi i të dhënave të pacientit si dhe informacioneve konfidenciale;
 - 1.20 Ngacmimi seksual me sjellje fizike apo verbale të natyrës seksuale;

- 1.21 Në qoftë se brenda një periudhe prej një (1) viti shqiptohen tri (3) vërejtje me shkrim nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë;
- 1.22 Mos respektimi i mjekut kujdestar në pranimin e pacientit për hospitalizim;
- 1.23 Mos regjistrimi i pacientit për hospitalizim në librin e protokollit nga personat përgjegjës;
- 1.24 Në rast se nuk raportohet me shkrim puna operatore pas operacionit;
- 1.25 Në rast se nuk lëshohet fletëlëshimi i nënshkruar brenda 24 orëve nga mjeku i cili e ka përcjellë gjendjen e pacientit;
- 1.26 Kërkimi apo marrja e vlerave monetare;
- 1.27 Nëse pranimi i dhuratës nuk njoftohet me shkrim brenda 24 orëve, pas pranimit të dhuratës,
- 1.28 Lëvizja e të punësuarve me uniformë jashtë objektit të institucionit;
- 1.29 Referimi i pacientëve në njërin nga institucionet shëndetësore private edhe pse ai shërbim nuk mund të ofrohet
- 1.30 Flirtimi (vardisja) me përcjellësit e pacienteve nga ana e të punësuarve gjatë kohës sa pacienti është i hospitalizuar;
- 1.31 Fshehja e fakteve, provave apo të dhënave zyrtare, kur ato kërkohen për qëllime zyrtare;
- 1.32 Jep informata për institucionin pa autorizim;
- 1.33 Paraqitje të pa autorizuara publike në emër të institucionit;
- 1.34 Diskriminimi ose keqtrajtimi i drejtpërdrejtë kundër pacientit në bazë të gjinisë, racës, gjuhës, religjionit, mendimeve politike, aftësive psikofizike dhe shtatzënisë;
- 1.35 Largimi nga vendi i punës gjatë orarit të rregullt, kujdestarisë, pushimit mjekësor, gjatë kohës se paузës për punë në institucione private;
- 1.36 Mosrespektimi i vendimit lidhur me caktimin në punët dhe, detyrat e punës në një vend tjetër brenda dhe jashtë Institucionit ku punon, kur paraqitet nevoja për angazhim në mungesë të stafit profesional të Institucionit i cili ka nevojë për kuadër në nivel të SHSKUK-së;
- 1.37 Mungesa pa arsye e dëshmitarëve në seancat disiplinore të Komisionit disiplinor dhe tek Shefi i Sektorit të Personelit, kur thirren me kohë dhe në mënyrë të rregullt;
- 1.38 Mos raportimi apo raportimi i pjesshëm me kohë i çështjeve me rëndësi për institucionin tek punëdhënësi;
- 1.39 Mos informimi i udhëheqësve të njësive organizative të SHSKUK-së (me shkrim ose verbalist nga zyrtari për informim), lidhur me rastet kur mediumet kërkojnë informata direkte;
- 1.40 Mos informimi me kohe lidhur me vendimet e plotfuqishme;
- 1.41 Refuzimi i urdhërësës, moskryerja ose kryerja e pjesshme e detyrave të punës dhe neglizhenca në punë;
- 1.42 Raportim tendencioz (i rrejshëm) i një shkelje të supozuar nga raportuesi i shkeljes me qëllim diskreditimi.
- 1.43 Shfrytëzimi i pushimit mjekësor në kundërshtim me udhëzimet e mjekut.
- 1.44 Lëshimi i afateve të përcaktuara me këtë rregullore, për zhvillimin e procedurave në komisionin disiplinor nga zyrtari kompetent.

Neni 8

Identifikimi i shkeljes disiplinore

1. Çdo shkelje e supozuar duhet të paraqitet në sektorin e personelit tek zyrtari i procedurave disiplinore.
2. Shefi i Sektorit të Personelit dhe zyrtari i procedurave disiplinore menjëherë pas pranimit të raportit me gojë apo me shkrim për shkelje të supozuar disiplinore, duhet që brenda **5 (pesë) dite** të hetojë rastin, të marrë deklaratën me shkrim të shkelësit të supozuar, të intervistojë personin që ka raportuar, të analizojë detajet e dhëna në deklaratë, dhe mbledhjen e provave të tjera lidhur me shkeljen e supozuar.
3. Zyrtari i procedurave disiplinore, njoftimin e propozuar bashkë me dëshmitë dhe shkresat tjera ia dorëzon ZKA-së për të vendos se:

- nuk ka shkelje të supozuar disiplinore,
- ka shkelje të lehtë disiplinore dhe përmes ZKA t'i shqiptojë një masë të drejtpërdrejtë apo,
- ka shkelje të rëndë të supozuar ta procedon në Komisionin disiplinor në procedurë të mëtijshme dhe vendosje.

Neni 9

Komisioni disiplinor

1. Komisioni disiplinor për SHSKUK-në dhe QKUK-në, emërohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së, ndërsa për Spitalet e Përgjithshme Këshilli Drejtues i Spitaleve përkatëse.
2. Komisioni përbëhet nga **5 (pesë)** anëtarë, **2 (dy)** anëtarë të rregullt dhe **2 (dy)** zëvendës me mandat **2 (dy)** vjeçar me mundësi vazhdimi dhe anëtari i tretë sipas rastit.
3. Komisioni Disiplinor vepron në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
4. Komisioni vendimet i merr me konsensus dhe, nëse nuk arrihet konsensus atëherë vendimi merret me shumicë të thjeshtë.
5. Në rastet e konfliktit të interesit, kur objektiviteti i anëtarit të komisionit do të vihet në dyshim, do të zëvendësohet dhe do të caktohet një zëvendës për atë seancë të veçantë dhe atë në rastet:
 - 5.1. kur anëtari i komisionit është në pozitë të udhëheqësit ndaj shkelësit të supozuar dhe, ka lidhje me shkelësin nga ana familjare,
 - 5.2. kur anëtari i komisionit ka qenë viktimë e shkelësit të supozuar ose ka lidhje me viktimën nga ana familjare,
 - 5.3. Asnjë person nuk ka të drejtë të ushtrojë ndikim, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj anëtarëve të Komisionit Disiplinor,
 - 5.4. Anëtarët e Komisionit Disiplinor nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit të Ankesave,
 - 5.5. Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së për SHSKUK-në dhe QKUK-në dhe Këshilli Drejtues i njëjsteve përbërëse mund ta shkarkojnë secilin anëtar të komisionit për mos efikasitet, neglizhencë apo paaftësi në përmbushjen e mandatit të tyre.
 - 5.6. Në Komision Disiplinor duhet të ftohet përfaqësuesi i Sindikatës përkatëse.
 - 5.7. Sipas kërkesës së shkelësit të supozuar, për përjashtim të Kryetarit apo anëtarit të Komisionit Disiplinor vendos Drejtori i institucionit shëndetësor përkatës.

Neni 10

Mbështetja e komisionit disiplinor

1. Zyrtari i procedurave mbështet komisionin disiplinor duke ofruar:
 - 1.1. Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe instruksioneve për anëtarët e Komisionit,
 - 1.2. Grumbullimin e dëshmive, evidencave, shënimeve të dokumentuara,
 - 1.3. Përgatitjen e orarit të seancave, njoftimin e palëve për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së seancës dhe, duke njoftuar shkelësin e supozuar që ka të drejtë të ketë shoqërues,
 - 1.4. Mbajtja e procesverbalit të seancës disiplinore bëhet nga procesmbajtësi dhe në fund të seancës nënshkruhet nga të gjitha palët në proces,
 - 1.5. Seanca disiplinore duhet të mbahet sa më shpejt që është e mundur dhe, në çdo rast jo më vonë se **30 (tridhjetë) ditë**, kurse vendimi duhet të merret brenda **60 (gjashtëdhjetë) ditëve**, prej ditës së lajmërimit të rastit,

1.6. Në qoftë se ndonjëra nga palët nuk merr pjesë në seancë me arsye, komisioni takohet gjithsesi për të kryer intervistën me palën prezent dhe vendos të organizojë seanca deri në përfundimin e procedimit disiplinor,

1.7. Mungesa e raportuesit të shkeljes disiplinore të supozuar në dy seanca radhazi dhe është ftuar në mënyrë të rregullt dhe me kohë, konsiderohet se ka tërheq raportin mbi shkeljen disiplinore të supozuar,

1.8. Mungesa e shkelësit të supozuar në dy seancat radhazi dhe është ftuar në mënyrë të rregullt dhe me kohë dhe i njëjti nuk i arsyeton mungesat, Komisioni do të vendos për rastin në mungesë të shkelësit të supozuar,

1.9. Mos pjesëmarrja e dëshmitarëve pa arsye të cilët janë të ftuar të marrin pjesë në seancë dhe deklarimi i tyre se nuk do t'i përgjigjen ftesës, do t'i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore,

1.10. Nëse shkelësi i supozuar ka vërejtje në përbërjen e komisionit disiplinor, është i obliguar që vërejtjet t'i deponojë me shkrim apo drejtpërdrejtë në procesverbal,

1.11. Për arsyeshmërinë e vërejtjeve vendos Komisioni disiplinor,

1.12. Në rastet kur ka dyshime të bazuara të veprës penale, atëherë Komisioni duhet të njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK-së lidhur me SHSKUK-në dhe QKUK-në, ndërsa për Njësitë Përbërëse të SHSKUK-së, Drejtorin Ekzekutiv ,

1.13. Komisioni nxjerr vendime dhe konkluzione sipas Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative.

Neni 11

Kompetencat e Komisioni disiplinor

1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca:

1.1 të dëgjojë dëshmitë, të administrojë provat dhe faktet;

1.2 të përcaktojë nëse shkelja është kryer;

1.3. të përcaktojë masën disiplinore;

1.4. Vendimi duhet t'i komunikohet shkelësit brenda **5 (pesë) ditësh** nga data e marrjes së vendimit.

Neni 12

Masat disiplinore për shkelje të lehta

1. Për shkeljet e lehta të përcaktuara me nenin 6. Pika 2. të kësaj Rregulloreje do të shqiptohet njëra nga këto masa disiplinore:

1.1. vërejte me gojë dhe

1.2. vërejtje me shkrim.

Neni 13

Masat disiplinore për shkeljet e rënda/serioze

2. Për shkeljet e rënda/serioze të përcaktuara me nenin 7 të kësaj Rregulloreje do të shqiptohet njëra nga këto masa disiplinore:

2.1. ndalesë administrative në shumën deri 20% nga paga bazë deri 3 muaj;

2.2. ulje në pozitë deri në 5 (pesë) vjet;

2.3. suspendim të përkohshëm;

2.4. ndërprerje të marrëdhënies së punës.

3. Për shkelje të lehta të vërtetuara nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë ose udhëheqësi më i lartë administrativ, mund të shqiptohen vërejtje me gojë ose vërejtje me shkrim, pa u paraqitur për shqyrtim në komisionin disiplinor.

Neni 14

Përgjegjësia materiale e punëtorit

Punëtori i cili me qëllim ose nga pakujdesia shkakton dëm material organizatës punuese, është i obliguar të kompensojë të njëjtin.

Nëse shkaktohet dëm material nga disa persona, ata të gjithë së bashku janë të obliguar të kompensojnë të njëjtin.

Nëse nuk mund të konstatohet se kush sa ka shkaktuar dëm, atëherë dëmi ndahet proporcionalisht për të gjithë.

Neni 15

Dëmin për SHSKUK-në dhe QKUK-në e konstaton komisioni i formuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, ndërsa për Njësitë Përbërëse të SHSKUK-së udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit,

Nëse dëmi është shkaktuar në inventar ose inventarin e imët, vlerësimi bëhet në bazë të raportit të kontabilitetit ose komisionit të posaçëm të autorizuar për amortizim dhe kohën e përdorimit.

Neni 16

Nëse punëtori refuzon kompensimin e dëmit inicohet procedurë në Gjykatën kompetente.

Neni 17

Komisioni ka të drejtë që t'ia lejojë shtyrjen e pagesës ose të paguajë në këste shumën e caktuar të dëmit.

Neni 18

Për shkaktimin e dëmit personit të tretë të cilin punëtori i shkakton në punë ose lidhur me punën vlejnë rregullat e cekura më lartë.

Neni 19

E drejta e ankesës

Pala e pakënaqur kundër vendimit ka të drejtë ankese në Komisionin për zgjidhje të kontesteve dhe, ankesave brenda afatit prej **pesëmbëdhjetë (15) ditësh** nga dita e pranimi të vendimit.

Neni 20

Ekzekutimi i vendimit

1. Vendimi i Komisionit Disiplinor ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së tij (pas kalimit të afatit për ankesë dhe vendimit të Komisionit për Ankesa).

Neni 21

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së dhe Udhëheqësit e lartë Administrativ të institucioneve.

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e jep Zyra për Çështje Juridike.

Neni 22

Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së.

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet sipas të njëjtës procedurë të miratimit.

Kryesuesi i Bordit Drejtues të SHSKUK-së
